

  
**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR RI-VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË  
FUNKSIONARIT PUBLIK Z. EDUARD HALIMI, ME DETYRË DEPUTET NË KUVENDIN E  
SHQIPËRISË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT  
TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.03.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	BIBA-	Kryetar
Hysen	OSMANAJ-	Zv/kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Gëzim	VELESHNJA-	Anëtar
Klement	ZGURI-	Anëtar
Vera	SHTJEFNI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** RI-Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik z. Eduard Halimi, me detyrë deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Neni 14, neni 15, i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 144 "Kodi i Procedurës Administrative".

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

**VËREN**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", është *organi kompetent* për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:



**Nr . 75 i vendimit      Data 23.03.2017 e vendimit      Ora 14:00 e vendimit**

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publik z. Eduard Halimi, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- Deputet të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit të sipërcituar brenda afati, (4 gusht 2016) të përcaktuar në pikën 5 të Kreut VI të Vendimit të Kuvendit 17/2016, KQZ në mbledhjen e datës 29 korrik, shqyrtoi të dhënat e pasqyruara në formularët e vetëdeklarimit për funksionarët publik, deputet, ministra që nuk janë deputet dhe kryetarët e bashkive.

Në përfundim të shqyrtimit KQZ, ndonëse nuk mori vendim, në mënyrë publike vlerësoi se asnjë prej funksionarëve publik të verifikuar nuk përfshihej në kushtet për ndërprerjen e mandatit dhe ndalimin e ushtrimit të funksionit, edhe pse të gjithë anëtarëve iu bë e qartë se një numër i caktuar subjektësh nuk kishin deklaruar në formular të dhëna të caktuara si ndryshime gjenealogjesh apo dënime të mëparshme.

Në një kohë të dytë, Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet Sektorit të Verifikimit të Integritetit, i kërkoi KQZ-së, në zbatim të nenit 8, pika 2 të ligjit 138/2015, verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për 10 funksionarë publik.

Pas verifikimit të formularit në përputhje me nenin 15, pika 1 të ligjit 138/2015 dhe Kreu VI, pika 6 Kreu V, pika 3, germa b e vendimit të Kuvendit 17/2016, KQZ vendosi t'ia kalojë rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme brenda 5 ditëve, në lidhje me mundësinë e evidentimit të të dhënave të tjera, të panjohura për KQZ. KQZ gjithashtu i dërgoi Prokurorisë së Përgjithshme analizën e plotë të të dhënave në formularët e vetëdeklarimit, dhe ose në informacion shtesë, të bëra nga funksionarët pas afatit ligjor, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile si dhe vlerësimin e KQZ në lidhje me shqyrtimin e këtij dokumentacioni.

Referuar shkresave nr.451/7.Prot, datë 13.03.2017 dhe nr. 456/11, datë 13.03.2017, Prokuroria e Përgjithshme, i ka dërguar në KQZ, vendimet "Për rezultatin të verifikimit" përkatësisht për z. Tërmet Nuro Peçi me detyrë Kryetar i Bashkisë Tepelenë, dhe z. Adriatik Mallq Zotkaj me detyrë Kryetar i Bashkisë Poliçan.

KQZ, referuar nenit 15 të ligjit 138/2015, Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është institucioni kompetent për shqyrtimin e rezultateve të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga shqyrtimi i procesit të verifikimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme për dy funksionarët e sipërpërmendur rezulton se nuk ka asnjë të dhënë shtesë nga verifikimi i kryer, në lidhje me dënime me vendim gjyqësor të formës së prerë me vendime jopërfundimtare, masa sigurimit apo të urdhëra dëbimi.

Rezultati i verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme është bërë në bazë të të dhënave të cilat KQZ i ka vënë në dispozicion më shkresat përkatëse, apo të dhëna të konfirmuara dhe nga vendimet gjyqësore dhe vërtetimet gjyqësore të cilat Prokuroria e Përgjithshme i ka administruar në organet kompetente (Gjykata dhe Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve).

Në përfundim, rezulton se nga verifikimi i kryer nga Prokuroria e përgjithshme, nuk ka të dhëna shtesë përveç sa KQZ ka patur në dispozicion prej kohësh.

Vlerësimi i Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me këto të dhëna është se: "subjektet deklaruese", z. Adriatik Zotkaj dhe z. Tërmet Peçi përfshihen në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit aktual si kryetarë bashkie të parashikuara në vendimin e Kuvendit, nr.17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



**Nr . 75 i vendimit                      Data 23.03.2017 e vendimit                      Ora 14:00 e vendimit**

Për Ri-verifikimin e deklaramëve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publik z. Eduard Halimi, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Vlerësimi i Prokurorisë bazohet në Kreun, III, pika 3, ç) të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, sipas të cilit formulari, (që plotësohet dhe firmoset nga subjekti vetëdeklarues), përmban një rubrikë ku detyrimisht pasqyrohet se "Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të sjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/apo emërimi nga funksioni publik".

Sipas arsytimit të Prokurorisë, këta subjekte, duke nënshkruar në faqen e dytë të formularit të miratuar me vendimin nr.17/2016 të Kuvendit, mbajnë përgjegjësi të plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota në lidhje me të kaluarën e tij kriminale. Rrjedhimisht, fakti që në formularin e depozituar brenda afatit nuk është pasqyruar asnjë e dhënë në lidhje me dënime me vendim të formës së prerë (qoftë edhe me gjobë) i bënë këto subjekte të përfshihen në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Bazuar në arsyetimin e Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me subjektet vetëdeklaruese z. Adriatik Zotkaj, kryetar i Bashkisë Poliçan dhe z. Tërmet Peçi, kryetar i bashkisë Tepelenë, KQZ konstaton se nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Eduard Halimi, janë të njëjtat kushte, pasi ka pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit të dhëna të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, gjë që në bazë të Formularit të vetëdeklarimit "sjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/apo emërimi nga funksioni publik".

Funksionari publik z. Eduard Halimi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë nuk ka deklaruar brenda afatit ligjor në Formularin e vetëdeklarimit ndryshime në gjenealitete, konkretisht nuk ka deklaruar ndryshimin e emrit nga "Eduart" në "Eduard" dhe mbiemrit nga "Halim" në "Halimi".

Formulari i vetëdeklarimit në Rubrikën "B" parashikon si më poshtë:

### **B. Gjenealitete të mëparshme**

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)

<b>EMËR</b>	
<b>MBIEMËR</b>	
<b>ATËSI</b>	
<b>AMËSI</b>	
<b>DATËLINDJE</b>	
<b>VENDLINDJE</b>	

Kodi i Procedurave administrative në nenin 144 "Rishikimi", parashikon se:

1. Rishikimi është mjeti ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod.
2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shpresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të Procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.

**Nr . 75 i vendimit**

**Data 23.03.2017 e vendimit**

**Ora 14:00 e vendimit**



Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publik z. Eduard Halimi, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave në zotidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 29 korrik 2016, nuk e shqyrtoi duke nxjerr konkluzionin e verifikimit me një akt administrative, çështjen e mosdeklarimit, brenda afatit të përcaktuar në nenin 15 të ligjit 138/2015 në formularin e vetëdeklarimit të ndryshimeve në gjenealitete dhe konkretisht nuk ka deklaruar ndryshimin e emrit nga "Eduart" në "Eduard" dhe mbiemrit nga "Halim" në "Halimi", për z. Eduard Hallmi. Referuar nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative, duke qenë se sipas rezultatit të verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme ka disa të dhëna të reja, të cilat kanë rëndësi për çështjen duke e zgjidhur atë në themel, dhe në mënyrë përfundimtare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të rishikojë vendimmarrjen e tij të datës 29 korrik 2016, në lidhje me verifikimin e formularit të vetëdeklarimit për funksionarin publik z. Eduard Hallmi.

Në lidhje me arsyetimin e vendimit nga Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shprehet se:

Për sa i përket vlerësimit të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Eduard Hallmi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duhet t'i referohet:

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligji nr. 137/2015 "Për disa shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar, konkretisht neni 6/1 dhe 45, paragrafi i tretë.

#### **Neni 6/1**

*"Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit."*

#### **Neni 45, paragrafi i tretë**

*"përfshihen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit"*

Ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe konkretisht nenit 2, nenit 3, nenit 5.

#### **Neni 2**

*Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik 1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për:*

*a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal;*

*b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/c, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal;*

**Nr . 75 i vendimit**

**Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14:00 e vendimit**



Për RI-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publik z. Eduard Hallmi, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

c) kryerjen e një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim;

ç) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

2. Ndalimi i parashikuar nga pika 1, e këtij neni, zbatohet edhe ndaj personave:

a) që janë dënuar me një vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, apo për të cilët është vendosur masë sigurimi personal dhe/ose është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar nga autoritetet e një prej këtyre shteteve, për kryerjen apo tentativën e kryerjes së një prej veprave penale, të parashikuara në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni. Për personat që plotësojnë kushtet e këtij paragrafi, ndalimet zbatohen në përputhje me pikën 5, të nenit 10, dhe pikën 1, të nenit 16, të këtij ligji;

b) që janë dënuar nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, në lidhje me një prej rasteve të parashikuara në pikën 1, shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, apo janë dënuar për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit përkatës.

### **Neni 3**

Ndalimi për t'u emëruar në një funksion publik

1. Për veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, personi nuk mund të emërohet apo zgjidhet në funksionet publike si më poshtë:

a) në organe kushtetuese apo të krijuara me ligj;

b) gjyqtarë ose prokurorë

c) në postin e zëvendësministrit apo të njëjvlershëm me të;

ç) në postin e prefektit;

d) funksionarë politikë në kabinetet e drejtuesve të çdo institucioni kushtetues apo të krijuar me ligj;

dh) në Shërbimin Informativ Shtetëror dhe shërbime të tjera informative;

e) në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik si dhe drejtues të çdo niveli ne administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil;

ë) në Policinë e Shtetit;

f) ushtarakë të forcave të armatosura, si dhe

g) në çdo post drejtues të kompanive që zotërohen plotësisht apo në maxhorancë ose administrohen nga shteti.

### **Neni 5**

Vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave

1. Personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3, të këtij ligji, duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar.

2. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit.

3. Formulari i vetëdeklarimit plotësohet vetëm nga personi që është subjekt i këtij ligji. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal".

Në rastin e z. Eduard Halimi, i cili nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit ndryshimet në gjenealitet dhe konkretisht nuk ka deklaruar ndryshimin e emrit nga "Eduart" në "Eduard" dhe mbiemrit nga "Halim" në "Halimi", KQZ duhet t'i japë përgjigje, pyetjeve:

1. A përbën shkak për ndalimin e ushtrimit të funksionit, fakti që funksionari publik nuk ka deklaruar ndryshime në gjenealitet, në formularin e vetëdeklarimit.



**Nr. 75 i vendimit**

**Data 23.03.2017 e vendimit**

**Ora 14:00 e vendimit**

Për Ri-verifikimin e deklaramëve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publik z. Eduard Halimi, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zotëohen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i referohet së pari Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe më pas ligjit nr.138/2015.

Kushtetuta, referuar nenit 45 paragrafi 3 të saj dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 2 të tij parashikon se, përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për dështim vepra penale të përcaktuar në mënyrë shteruese. Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore të cituara më sipër, funksionarët publikë kanë detyrimin për të deklaruar të dhëna për dënime me burgim me vendim të formës së prerë, për me jo më pak se 6 muaj, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Referenca e organit të prokurorisë, në lidhje me rastet në fjalë, nuk bëhet në mbështetje të parashikimeve kushtetutës dhe të ligjit, por bëhet në lidhje me vendimin e Kuvendit nr. 17/2016, pika 3, germa "ç" dhe formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues. Pikërisht kërkesa në rubrikën 1 të formularit të vetëdeklarimit i miratuar nga Kuvendi, është në tejkalim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Interpretimi i organit të prokurorisë bie ndesh haptazi me parashikimet e nenit 3 të ligjit nr. 138/2015 ku janë caktuar shprehimisht rastet e ndalimit për t'u emëruar në një funksion publik dhe referenca ligjore për ndalimin për emërim apo zgjedhje në funksionet publike të cituara në këtë dispozitë i referohet po ligjit dhe vetëm nenit 2, pika 1 të tij.

Neni 5 i ligjit parashikon:

- subjektet që kanë detyrimin për të deklaruar dhe
- përcakton se çfarë detyrimesh kanë këta persona.

Sipas kësaj dispozite detyrimi i subjekteve është që të plotësojnë dhe të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit duhet të deklarojnë mosegzistencën e shkaqeve për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur apo për të mos u emëruar. Shkaqet për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur apo për të mos u emëruar janë vetëm shkaqet e përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr.138/2015. Të tilla shkaqe dispozitat e sipërcituara kanë përcaktuar dënimin me burgim jo me pak se 6 muaj për kryerjen e një krimi brenda apo jashtë Shqipërisë, pasja e një mase sigurimi personal ose një urdhër kërkimi ndërkombëtar si dhe dëbimi nga territori i një shteti anëtar të BE, SHBA, etj.

Kjo do të thotë se subjektet vetëdeklaruese kanë detyrimin që të deklarojnë dënime për kryerjen e një krimi, me burgim për jo më pak se 6 muaj, si dhe masat e tjera të parashikuara nga neni 2, pika 2 e ligjit nr.138/2015, çdo e dhënë tjetër, e cila parashikohet të deklarohej në formularin e vetëdeklarimit, është e dhënë plotësuese e cila i shërben organeve përgjegjëse për të lehtësuar procesin e verifikimit.

Vendimi i Kuvendit nr.17/2016, pika 3, germa "ç" parashikon shprehimisht se: "*pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik*". Pikërisht ky është parashikimi i vendimit të Kuvendit ku mbështetet edhe argumenti se "subjekte të caktuara ndodhen në kushtet e ndalimit për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik", nga ana e organit të prokurorisë. Referenca formale dhe në mënyrë të shkëputur në këtë pikë të vendimit të Kuvendit është e gabuar sepse:

Së pari, nëpërmjet këtij parashikimi gjendemi në situatën që vendimi i Kuvendit ka parashikuar një rregull material, që në fakt, nuk është detyra e një vendimi që ka dalë për zbatim të ligjit dhe të Kushtetutës, të parashikojë rregulla materiale. Një parashikim i tillë është tipik ligjor. Sipas hierarkisë së normave të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta vendimi në fjalë nuk mund të zëvendësoj ligjin e aq më tepër Kushtetutën.



**Nr . 75 i vendimit**

**Data 23.03.2017 e vendimit**

**Ora 14:00 e vendimit**

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publik z. Eduard Halimi, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

7

Sipas ligjit nr.138/2015 e konkretisht nenit 6 të tij, pika 1, "Kuvendi miraton me vendim rregullat e detajuara dhe afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve, si dhe për marrjen e masave për zbatimin e ndalimeve të parashikuara nga ky ligj". Pra, me fjalë të tjera nuk mundet dot Vendimi, qoftë ky dhe i miratuar nga Kuvendi të parashikoj ndryshe nga sa ka parashikuar ligji, sikurse ka ndodhur në rastin në fjalë. Tejkalimi i parashikimeve nga ana e një akti më të ulët në hierarkinë e normave ligjore nuk mund ta bëjë të ligjshëm këtë parashikim.

Hierarkia e normave ligjore është parashikuar shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e konkretisht në nenin 116 të saj duke renditur si më poshtë:

"AKTET NORMATIVE Neni 116 i saj:

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) Kushtetuta;
- b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c) ligjet;
- ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

Vendimi i Kuvendit në këtë rast nuk përmendet fare, por duke konsideruar delegimin që ka bërë vetë ligjvënësi, theksojmë se, sa më sipër, primati i normës ligjore është i padiskutueshëm në raport me një normë tjetër më të ulët se ajo në hierarkinë e normave.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se parashikimi i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, e konkretisht, pika 3, germa "ç", se: "pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik", do të duhet të zbatohet gjithnjë nëse pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta që kanë lidhje me veprat penale që parashikon ligji dhe në asnjë rast përtej tij.

Neni 2 i ligjit 138/2015 nuk e parashikon mosdeklarimin e ndryshimeve në gjenealltete si rast që të përfshihet në fushën e ndalimit për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publikë.

Sa më sipër është e lidhur ngushtësisht edhe me parashikimet e nenit 1 të ligjit 138/2015 "Qëllimi dhe objekti" ku parashikohet shprehimisht se: "1. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar PËR KRYERJEN TË KRIMEVE, SIPAS KËTJË LIGJI".

Pra, edhe vetë qëllimi i ligjit lidhet me parashikimet e ndalimeve të parashikuara shprehimisht prej tij dhe vetëm për veprat penale që vetë ky ligj parashikon dhe jo përtej tij.

Prokuroria vjen me konkluzionin se subjekte të caktuara përfshihen në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit pikërisht nën këtë parashikim të Vendimit të Kuvendit, duke injoruar kushtetutën dhe ligjin. Pra, thënë ndryshe, penalizimi në rastin konkret nga ana e organit të prokurorisë bëhet mbi bazën e një akti që ka dalë në bazë e për zbatim të ligjit, është njësoj sikur prokurori të bazojë ngritjen e akuzës duke u bazuar në Kodin e Procedurës Penale që është mjeti nëpërmjet të cilit prokuroria shkon drejt realizimit të dënimit të parashikuar, ky i fundit nga Kodi Penal, ose për të ruajtur hierarkinë me rastin në fjalë, me një udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm. Të gjitha rendet shoqërore të shoqërisë njerëzore, nga më i thjeshti e deri tek ata më diktatorialët janë mbështetur mbi rregullat të shkruara apo të pashkruara qofshin ato. Dhe rregulli në këtë rast është ajo çfarë Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar shprehimisht

**Nr . 75 i vendimit**

**Data 23.03.2017 e vendimit**

**Ora 14:00 e vendimit**



Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publik z. Eduard Halimi, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zotidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

"Nuk ka dënim pa ligj neni 7 i KEDNJ, "Vetëm ligji mund të urdhërojë një ndëshkim". Këto janë parime esenciale të shtetit të së drejtës.

Në rastin konkret të z. Eduard Halimi, duke mos shënuar ndryshime ne gjenealitete në rubrikën "B" të formularit, nuk është në kushtet e parashikuara nga neni 2 i ligjit 138/2015 dhe në këto kushte mos deklarimi i ndryshimeve në gjenealitete, nuk përbën shkak për të mos u zgjedhur, mos u emëruar apo për të humbur funksionin që ka.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë verifikimin edhe pas ardhjes së përgjigjeve të para nga Zyra e Gjendje Gjqësore edhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka konkluduar se subjektet në fjalë nuk gjenden në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik të parashikuara nga ky ligj. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 138/2015 e konkretisht nenit 2 pika 3 e tij ku parashikohet se "3. Ndalimet e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe ndaj personave që, në kohën e kryerjes apo tentativës së kryerjes të veprës penale, të parashikuar në këtë ligj, mbanin të dhëna identiteti të ndryshme nga ato që mbajnë në momentin kur zbatohet ndalimi ndaj tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet verifikimit pranë Zyrës së Gjendjes Gjqësore, ka mundësinë të identifikojë nëse subjektet deklaruese kanë patur dhe gjenealitete të tjera. Rasti i z. Eduard Halimi do ti referohet për kontroll edhe me gjenealitetet e mëparshme të padeklaruara, institucioneve kompetente si Zyrës së Gjendjes Gjqësore dhe Zyrës së Gjendje Civile. Në çdo rast nëse nga riverifikimi pranë institucioneve kompetente me gjenealltete e mëparshme rezulton se funksionari publik është në kushtet e parashikuara nga neni 2 i ligjit 138/2015, kjo përbën shkak për ndërprerjen e mandatit. Subjekti vetëdeklaruar z. Eduard Halimi nuk ka asnjë shënim në formularin e vetëdeklarimit dhe nga verifikimet e kryera në përputhje me ligjin nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk rezulton asnjë e dhënë që z. Eduard Halimi të mund të përfshihen në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 14, nenin 15, të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 144 "Kodi i Procedurës Administrative".

**VENDOSI:**

1. Të shpall të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Eduard Halimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<b>Denar</b>	<b>BIBA-</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Gëzim</b>	<b>VELESHNJA-</b>	<b>Anëtar</b>

*(Handwritten signatures and names in parentheses: (Kryetar), (Anëtar), (Anëtare), (Anëtar))*

**Nr . 75 i vendimit      Data 23.03.2017 e vendimit      Ora 14:00 e vendimit**

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publik z. Eduard Halimi, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

